



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS**

---

**NJOFTIM PËR MEDIAT**

**Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano”**

**TIRANË, 26 gusht 2011** - Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij të fundit, me shumice votash vendosi marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në tregun gjeografik “Porto Romano”. Ky vendim i Komisionit të Konkurrencës është marrë pas shqyrtimit të ankesës së ndërmarrjes “Prima Gaz”, një operatori në tregun e importit dhe tregtimit të gazit të lëngëzuar të naftës(GNL). Ky operator nuk është lejuar të përdorë portin “Porto Romano”, dhene me koncesion nga Shteti Shqiptar ndërmarrjes “Romano Port” SHA, për shkarkimin e një anijeje me GNL që nga data 12.08.2011

Referuar pikës 4 të marrëveshjes së koncesionit, koncesionari detyrohet të respektojë të drejtën e barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime nëpërmjet këtij objekti, duke respektuar legjislacionin në fuqi në këtë fushe dhe ky koncesion do të jetë e vetmja veprimtari që ka të drejtë të kryejë koncesionari, sipas objektit të kësaj marrëveshjeje.

Ky është rasti i dytë i shqyrtuar nga Autoriteti i Konkurrencës, ku “Romano Port” SHA refuzon shkarkimin e anijeve të disa shoqërive që veprojnë në sektorin e tregtimit të gazit të lëngshëm.

Si konkluzion, Komisioni i Konkurrencës konstaton se jemi përpara rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën.

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 9, nenit 24, germa (d), nenit 26 dhe nenit 44, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” vendosi:

1. Marrjen e masës së përkohshme si vijon: *“Porto Romano” SHA të bëjë të mundur përpunimin e anijes me GLN të sjellë nga ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA në mënyrë të menjëhershme dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga njoftimi i këtij vendimi”.*
2. Te garantoje zbatimin e menjëhershëm të detyrimit ligjor që ka shoqëria “Romano Port”SHA për të bere të mundur shkarkimin e anijeve të shoqërive të tjera që veprojnë në sektorin e tregtimit të GLN-se, me qëllim hapjen e tregut dhe sigurimin e konkurrencës së lire.

Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme ndërmarrja përgjegjëse rrezikon të ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b e ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Ndërsa në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, Komisioni i Konkurrencës mund të vendosë gjoba periodike për çdo ditë vonese deri në 5 % të xhiros mesatare ditore, deri sa shoqëria “ROMANO PORT” SHA të veprojë në përputhje me vendimin për masat e përkohshme.

Këto masa të përkohshme merren për një periudhë kohore deri në përfundim të hetimeve të hapura nga Autoriteti i Konkurrencës në tregun e ngarkimit dhe shkarkimit të gazit të lëngshëm GNL.

**Vendimin e plotë të Komisionit të Konkurrencës për marrjen e masave të përkohshme e qendrimin e të gjithë anetareve të Komisionit mund ta gjeni në faqen e internetit të Autoritetit të Konkurrencës.**